



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



DATË/A:	09 qershor 2020
REFERENCË:	307/20
PËR/ZA/TO:	AK- Kuvendi Komunal Rahovec
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina Kryetar i panelit shqyrtues- OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM



Operatori ekonomik NTSHM “Letamed” dhe NTSH “AtomMed”- Suharekë, si palë e pakënaqur me datën: 18 maj 2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 307/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së” me numër të prokurimit:623-20-1051-1-2-1, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 6, 7 të LPP-së si dhe neni 4.1, 4.4, 41.3, 41.5 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 26 maj 2020 kanë autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik me datën 02 qershor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues te aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Rahovec me datën 02 qershor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtit me datën 05 qershor 2020 përmes parashtrësës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me datën 02 qershor 2020 ka pranuar nga OSHP raportin e ekspertizës dhe të njëjtit përmes parashtrësës me shkrim me datën 04 qershor 2020 kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së që **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë.

Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Rahovec për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së” me numër të prokurimit:623-20-1051-1-2-1, duhet të anulohet njoftimin mbi vendimin e AK-së, për dhënie dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**, konform mendimit të dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik NTSHM “Letamed” dhe NTSH “AtomMed”- Suharekë, konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.